



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Integrimit Europian
Ministarstvo za Evropske Integracije/ Ministry of European Integration

Ministria e Integrimit Europian duke u bazuar ne Ligjin për Shërbimi Civil të Republikës se Kosovës L.Nr. 03/L-149 dhe Rregulloren nr 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit ne Sherbimin Civil te Republikës se Kosovës shpall konkurs :

Një (1) Zyrtar i Transportit
Referenca e titullit të punës (MIE-DFSHP-0010)
Koeficienti : 6
Vendi: Prishtinë

Qëllimi vendit të punës:

- Mirëmbajtja dhe shfrytëzimi sa më racional i veturave të MIE-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit te divizionit zyrtari i transporti ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Sigurimi , regjistrimi dhe mbajtja e kartotekës së veturave zyrtare.
- Mbanë evidencën e urdhëresave të punës për autoservise.
- Kujdeset për dërgimin e veturave në servise;
- Mbanë dosjen ne rast te veturave te aksidentuara;
- Mbanë evidencën dhe përgatitë pasqyrën e kilometrave te kaluara brenda çdo muaji dhe mbanë evidencën e kërkesave për vetura zyrtare;
- Mbajtja e statistikës për vetura zyrtare;
- Ofrimi i shërbimeve për zyrtaret qe kërkojnë vozitje zyrtare;
- Bënë shtypjen dhe plastifikimin e autorizimeve për vozitje ;
- Bënë pranimin e faktuarve për shërbimet e kryera në lëmin e transportit dhe i dorëzon për procedurën e mëtejme për pagesë;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së udhëheqësit të divizionit .

Shkathësitë e kërkuara (kualifikimet, përvojat si dhe shkathësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës)

- Shkollim te mesëm,
- Së paku një (1) vit përvojë pune,
- Njohja e gjuhës shqipe dhe serbe,
- Njohuria e gjuhëve tjera është përparësi,
- Aftësi të mira të komunikimit,
- Njohja e punës me kompjuter,
- Gatishmëri për të punuar tej orarit të rregullt të punës si dhe në trysni kohe.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve

Formulari për aplikim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (rruga Nëna Terezë p.n.) gjithashtu mund të tërhiqen edhe nga Web Faqja e internetit të MIE-së.

Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, kopjen e patentshoferit, referencat certifikata që nuk jeni nër hetime, etj, mund të dorëzohen:

- Drejtpërdrejtë në Zyrën e Personelit të MIE-së si dhe
- Përmes postës.

Aplikacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i plotësuar gabueshëm, do të konsiderohet i pavlefshëm dhe nuk do të merret në konsiderim.

Kandidatët duhet të dorëzojnë aplikacione me të dhëna të sakta. Në rast të mosplotësimit të këtyre kërkesave ose ofrimit të informatave jo të sakta, aplikacioni refuzohet, gjithashtu përdorimi i formularëve jozyrtar rezulton në refuzimin e menjëhershëm të aplikimit.

Aplikacionet e pranuar pas afatit të caktuar, konsiderohen të pranueshme nëse data në dërgesën postare, ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar (postuar) para kalimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve.

Kohëzgjatja e emërimit-punësimit bëhet në përputhje me LSHCK, në të cilën është e përfshirë periudha e punës provuese prej një (1) viti.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit dhe do të jetë i hapur nga data 31.01.2014 deri 14.02.2014 në ora 16.00.

Për informata shtesë mundë të kontaktoni Zyrën e Personelit të MIE-së, në telefonin:

038 200 27-062

Konkursi dhe kërkesa për punësim janë të publikuara edhe në Web-Faqene Ministrisë: www.mei-ks.net

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjestarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.